

1 E hënë, 9 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari Kuçi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 10.00

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëmëngjes, dhe të
7 gjithëve mirë se keni ardhur në këtë seancë paraqitje të parë.

8 Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, është
10 çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
11 Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe
12 Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, zonjë.

14 Përpara se të fillojmë seancën dëshiroj që fotografes t'i
15 jap rastin të bëjë disa fotografi.

16 Ju lutem bëni fotografitë, z. Fotograf.

17 Faleminderit, z. Fotograf.

18 Përpara se t'ju kërkoj të pranishmëve në sallë të
19 prezantohen, ju kujtoj të gjithëve rregullat që duhet të
20 respektohen gjatë të gjithë kohës për të siguruar ecurinë e
21 papenguar të kësaj seance.

22 Ju lutem ndizeni mikrofonin përpara se të flisni dhe
23 fikenitë posa të keni përfunduar. Flisni ngadalë dhe qartë, duke
24 qenë se kemi përkthim në shqip dhe prej shqipes dhe
25 serbishtes. Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni

1 mua apo palës tjetër, që përkthyesit të përfundojnë
2 përkthimin.

3 Ju kujtoj gjithashtu se një pjesë e informacionit në këtë
4 çështje është konfidencial. Informacioni konfidencial nuk
5 nxirret në seancë të hapur. Nëse ndonjë nga palët dëshiron të
6 diskutojë ose t'i referohet informacionit konfidencial, ju
7 lutem kërkonit të kaloni në seancë private.

8 Tani do t'ju kërkoj palëve të prezantohen duke filluar
9 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes. Joshua Hafetz në emër
11 të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe bashkë me mua këtu
12 janë Kim West dhe Earl Sullivan.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mbrojtja.

14 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam z. Admiraal.
15 Përfaqësoj z. Hajredin Kuçi.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Vë re se klienti Kuçi
17 është gjithashtu i pranishëm në sallë.

18 Tani ju lutem Zyrës së Prokurorisë -- Zyrës
19 Administrative.

20 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Unë jam
21 Whiteney Price [Sipas përkthimit], avokat dhe Jonas Wilson
22 [Sipas përkthimit] Zëvendësadministrator.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Dhe tani ju lutem, unë
24 jam Majorie Masselot, Gjykatëse e Procedurës Paraprake në këtë
25 çështje.

1 Kjo është seanca -- i akuzuari paraqitet sot për herë të
2 parë përpara Dhomave të Specializuara për konfirmimin e
3 aktakuzës kundër tij.

4 Ju lutem, mund të çoheni në këmbë z. Kuçi. Hapeni
5 mikrofonin.

6 Dhe ju lutem thoni si ju quajnë, emrin, mbiemrin, datën
7 dhe vendin e lindjes.

8 I AKUZUARI KUÇI: Unë jam Hajredin Kuçi, i lindur me 2
9 janar 1971 në Lutogllavë të Pejës. Me vendbanim në Prishtinë.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ju lutem më thoni se
11 çfarë kombësie keni, çfarë qytetari jeni nëse jeni i një apo i
12 më shumë shteteve?

13 I AKUZUARI KUÇI: Unë jam shqiptar me shtetësi të
14 Republikës së Kosovës, po kam shtetësi edhe të Republikës së
15 Shqipërisë.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Na thoni ju lutem se
17 çfarë pune bëni, çfarë profesioni keni?

18 I AKUZUARI KUÇI: Unë jam profesor i Universitetit të
19 Prishtinës.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kuçi.
21 Uluni, ju lutem. Dhe mbylleni mikrofonin kur nuk flisni.

22 Përpara se të vazhdoj më tej, z. Kuçi, duhet të sigurojmë
23 që ju i kuptoni procedurat që po zhvillohen në një gjuhë që e
24 kuptoni. A mund të na thoni nëse flisni dhe kuptoni shqip?

25 I AKUZUARI KUÇI: Po, e kuptoj gjuhën shqipe, e kam gjuhë

1 amtare.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Jam e
3 bindur se mund -- ju lutem mbylleni mikrofonin tani.

4 Jam e bindur se mund t'i ndiqni procedurat në shqip, në
5 një gjuhë që e kuptoni, flisni, në pajtim me rregullin 92 të
6 Rregullores së Procedurës dhe Provave.

7 Nëse ndodh që gjatë një momenti nuk ju vjen përkthimi, ju
8 lutem më thoni menjëherë.

9 Tani mund të uleni.

10 Dhe tani do të bëj një histori të shkurtër për të
11 prezantuar seancën e sotme.

12 Në 29 nëntor 2024, në cilësinë time si Gjykatëse e
13 Procedurës Paraprake konfirmova pjesërisht aktakuzën e
14 dorëzuar nga Prokurorja e Specializuar kundër z. Hashim
15 Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe
16 Hajredin Kuçit në të cilën e akuzoj z. Kuçi për dy pika.

17 Gjithashtu kam dhënë një urdhër fletë-arresti për z. Kuçi
18 që të paraqitet përpara meje në Gjykatë. Në 5 dhjetor 2024
19 ZPS-ja i dha z. kuçi në Kosovë fletë-thirrjen për t'u
20 paraqitur dhe gjithashtu i dha akuzën në shqip.

21 Ju lutem më lejoni të bëj të qartë qëllimin konkret të
22 paraqitjes së parë për z. Kuçi.

23 Z. Kuçi, sot nuk është seancë gjyqësore. Nuk do të
24 paraqiten dhe as do debatohen prova dhe nuk do të diskutohet
25 fajësia apo pafajësia e jua.

1 Qëllimi i kësaj seance të parë rregullohet nga neni 39(5)
2 i Ligjit dhe rregulla 92 e Rregullores. Në pajtim me këto
3 dispozita, si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, do t'i lexoj
4 të akuzuarit akuzat në aktakuzë:

5 Do të konfirmoj që e kuptoni aktakuzën;

6 Do të bindem që të drejtat e të akuzuarit, sidomos e
7 drejta e tij për të pasur një avokat, të respektohen.

8 Do ta informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita
9 e sotme do të ftohet të vetëdeklarohet fajtoj ose i pafajshëm,
10 në lidhje me secilën akuzë të paraqitur në aktakuzë. Në qoftë
11 se i akuzuari dëshiron ta bëjë, dhe do të vijmë tek ajo pikë
12 mbas pak, ai menjëherë mund të deklarohet i fajshëm apo i
13 pafajshëm.

14 Dhe së fundi, do të caktoj data të tjera sipas nevojës në
15 kryerjen e detyrave të mia si Gjykatëse e Procedurës
16 Paraprake.

17 Këto janë çështjet që do trajtohen sot në seancën e
18 paraqitjes së parë. Nëse ndonjë nga palët dëshiron të
19 diskutojë ndonjë aspekt tjetër që nuk është paraparë
20 shprehimisht në kontekst të kësaj paraqitjeje, ju ftoj që ta
21 bëni këtë në formë të shkruar.

22 Së pari, z. Kuçi, ju lutem çohuni përsëri dhe ju lutem
23 konfirmoni që e keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë
24 që e kuptoni dhe e flisni. Hapni mikrofonin.

25 I AKUZUARI KUÇI: Po, e kam marrë aktakuzën në gjuhën

1 shqip dhe në gjuhën angleze.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit z. Kuçi.

3 Përpara se Sekretarja t'ju lexojë akuzat e konfirmuara
4 kundër jush, dëshiroj t'ju kujtoj se nuk është kjo koha për
5 t'i kundërshtuar, por thjesht të thoni që i pranoni. Do të
6 keni rastin t'i kundërshtoni akuzat me ndihmën e avokatit
7 tuaj.

8 Tani do t'i lutem Sekretares të lexojë akuzat në
9 aktakuzën e konfirmuar siç parashikohet në rregullën 35 të
10 Rregullores dhe në rregullin 92(2(b)).

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në Aktakuzën e
12 Konfirmuar, Prokurorja e Specializuar akuzon z. Hajredin Kuçi
13 për:

14 Pika 18: Mosbindje ndaj gjykatës, e ndëshkueshme në bazë
15 të nenit 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit
16 15(2) të Ligjit;

17 2. Kjo vepër është kryer të paktën midis 1 shtator dhe
18 deri në 13 shtator 2023.

19 Pika 19: Mosbindje ndaj gjykatës, e ndëshkueshme në bazë
20 të nenit 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit
21 15(2) të Ligjit;

22 3. Kjo vepër penale u krye në ose rreth datës 12 prill
23 2023.

24 4. Në lidhje me këto penale ekziston dyshimi i bazuar
25 mirë se z. Hajredin Kuçi mban përgjegjësi penale sipas nenit

1 16(3) të Ligjit për:

2 a. Kryerjes së veprës penale të mosbindjes të gjykatës në
3 nën Pikën 19, sipas nenit 17 të 2019 të Kodit Penal të
4 Kosovës;

5 b. Marrëveshje për kryerje me z. Hashim Thaçi të veprës
6 penale të mosbindjes ndaj gjykatës nën Pikën 18, sipas nenit
7 35 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

8 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

10 Z. Kuçi, a i kuptuat akuzat që përmban Aktakuza e
11 Konfirmuar që sapo ja u lexoi Sekretarja?

12 I AKUZUARI KUÇI: Po, i kam kuptuar.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kuçi.
14 Mund të uleni.

15 Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
16 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë disa të drejta. Do ju
17 lexoj më të rëndësishmet, konkretisht ato që janë me rëndësi
18 për këtë fazë të procesit.

19 Do të prezantoheni i pafajshëm deri në -- do të
20 prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë tuaj
21 përtej dyshimit të arsyeshëm.

22 Në marrjen e vendimit mbi akuzat kundër jush keni të
23 drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik në vartësi të
24 masave të urdhëruara për mbrojtjen e viktimave dhe
25 dëshmitarëve.

1 Keni të drejtën të konfirmoheni në kohë dhe me hollësi në
2 një gjuhë që e kuptoni dhe e flisni për natyrën dhe arsyet e
3 akuzave kundër jush.

4 Keni të drejtën të keni kohë dhe mundësi të mjaftueshme
5 për përgatitjen e mbrojtjes suaj, si dhe për të komunikuar me
6 avokatin mbrojtës që keni zgjedhur vetë.

7 Keni të drejtën të gjykoheni brenda një periudhe kohore
8 të arsyeshme.

9 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
10 mbronit -- të mbroheni nëpërmjet avokatit tuaj mbrojtës.

11 Keni të drejtën t'ju caktohet një avokat mbrojtës dhe pa
12 pagesë në qoftë se nuk dispononi mjete të mjaftueshme për
13 pagesën e Mbrojtësit.

14 Keni të drejtën të merrni ndihmën e një përkthyesi falas
15 nëse nuk e kuptoni apo flisni gjuhën apo gjuhët që përdoren në
16 Gjykatës.

17 Keni të drejtën të mos detyroheni të dëshmoni kundër
18 vetes apo të pranoni fajësinë.

19 Dhe keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nuk do të
20 nxirret përfundim negativ nga heshtja juaj.

21 Z. Kuçi, ju lexova të drejtat më të rëndësishme që gëzoni
22 në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.
23 A i kuptoni këto të drejta?

24 I AKUZUARI SMAKAJ: Po, i kam kuptuar.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kuçi.

1 Tani kam parasysh se jeni prezantuar me Mbrojtësin
2 Admiraal dhe jam i bindur se i akuzuari prezantohet si duhet
3 nga avokati mbrojtës.

4 Tani do të flas për të drejtat e të akuzuarit për t'u
5 deklaruar në përputhje rregullin 92 të Rregullores. Brenda 30
6 ditësh, z. Kuçi, do të thirreni nga seanca sot -- do të
7 ftoheni të vetëdeklaroheni fajtor ose i pafajshëm në lidhje me
8 akuzat e paraqitura në aktakuzë. Në qoftë se dëshironi mund të
9 zgjidhni që menjëherë të pranoni fajësinë apo të
10 vetëdeklaroheni i pafajshëm.

11 Prandaj po ju pyes, z. Kuçi, nëse keni pasur mundësi t'i
12 diskutoni akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar me
13 avokatin mbrojtës tuaj dhe nëse jeni i gatshëm të bëni
14 vetëdeklarim në këtë moment. Keni fjalën.

15 I AKUZUARI KUÇI: E nderuara, znj. Gjyqtare, do të
16 deklarohej tash.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Keni fjalën prapë. E
18 dëgjova.

19 I AKUZUARI KUÇI: Të nderuar zonja dhe zotërinj, jam
20 plotësisht i pafajshëm. Sot është një prej momenteve të errëta
21 për mua si njeri i drejtësisë që e ka profesion dhe mision
22 tërë jetën dhe jam i identifikuar me drejtësinë. Si profesor i
23 drejtësisë për mbi 30 vite, si ish-kryetar i komisionit
24 kushtetues të Republikës së Kosovës që kushtetuta ende është
25 në fuqi.

1 Si zëvendëskryeministër për rend dhe ligj për tri mandate
2 dhe ministri i drejtësisë për dy mandate, si anëtar i ekipit
3 mbrojtës të kryetarit Veseli pranë kësaj Gjykate, këtë
4 aktakuzë e shoh si prekje të dinjitetit tim njerëzor,
5 profesional, po dhe të reputacionit tim. Drejtësinë si
6 profesion dhe mision do ta vazhdoj dhe nga sot edhe në një
7 pozitë tjetër, por prapë në funksion të saj dhe të atyre
8 vlerave që jam identifikuar.

9 Më vjen keq për shqetësimet që kjo akuzë ju ka bërë
10 anëtarëve të familjes time. Ju ka bërë studentëve dhe kolegëve
11 të mi. Ju ka bërë shokëve dhe qytetarëve të Republikës të
12 Kosovës. Unë ju them atyre dhe sot, unë jam i njëjti ai që kam
13 qenë para datës 6 dhjetor 2024. Nuk do ta zhgënjej askënd, as
14 ju, as drejtësinë.

15 Më lejoni të jem i qartë, unë nuk kam bërë asnjë vepër
16 penale. Unë jam i pafajshëm dhe kam besim të plotë se do të
17 lirohem nga akuzat.

18 Në aktakuzë jam me Presidentin Hashim Thaçi. Më lejoni të
19 them se Hashimin e kam mik. Njihemi që vite të gjata dhe kemi
20 punuar gjatë. Gjatë tërë punës së bashku ne kemi punuar dhe
21 udhëhequr mbi parimin e drejtësisë, respektimit të saj edhe
22 kemi besuar në drejtësi. Unë si jurist kam përdorur sloganin:
23 Sundimi i ligjit me ligj. Edhe sot besoj se kjo Gjykatë po e
24 bën dhe do ta bëjë të njëjtën gjë.

25 Puna ime është identifikuar në funksion të nderimit të

1 drejtësinë. Në respektimin e vendimeve gjyqësore, në besimin
2 në drejtësi dhe jo në mosbindje ndaj urdhrave të Gjykatës
3 çfarë thotë akuza. Edhe në kohën kur isha në ekipin mbrojtës,
4 edhe atëherë kur kam pas mundësi që përmes ligjit dhe
5 protokollit të kësaj Gjykate të takohem me dëshmitarë, këtë të
6 drejtë nuk e kam shfrytëzuar asnjëherë, ç'ka dhe mund të
7 vërtetohet. Nuk kam dashur që të fitohet perceptim për ndonjë
8 keqkuptim eventual.

9 Sikur e thashë dhe në fillim, drejtësia për mua është
10 mision dhe profesion. Do të vazhdon edhe sot dhe do të duket
11 kështu në të ardhmen. Besoj të gjithë në këtë sallë jemi në
12 anën e drejtësisë që e kemi pikësynim arritjen e të vërtetës
13 dhe rritjen e besimit në drejtësi për secilin në këtë sallë
14 dhe jashtë saj.

15 Zonja dhe zotërinj, e nderuar Gjyqtare, besimi në Zot dhe
16 një drejtësi nuk e luhati edhe kur sfidohem personalisht. Edhe
17 kur duket se ata janë në anën tjetër prej meje, ngase unë me
18 bindje unë çdo herë jam në anën e tyre. Faleminderit për
19 vëmendjen.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Z. Kuçi, meqë keni
21 zgjedhur të deklaroheni jofajtor për të dy pikat, do të
22 vazhdojë procesi për t'u përgatitur për gjyq sipas rregullës
23 95 të Rregullores.

24 Tani do të kalojmë tek gjuha e punës së procesit.

25 Mund të uleni, mund ta mbyllni dhe mikrofonin, ju lutem.

1 Në vendimin për të caktimin e datës për paraqitjen e parë
2 dhe çështje të lidhura, i ftoj palët të bëjnë parashtrime
3 gojore sot për gjuhën e punës që do të përdoret në këtë
4 çështje sipas rregullit 8 të rregullores. I lutem palëve të
5 vënë në dukje preferencat e tyre për procesverbal, duke
6 filluar nga Prokurori i Specializuar që e përmendi dje disa
7 herë, por për procesverbal duhet ta themi.

8 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne vazhdojmë të themi se anglishtja
9 është gjuha jonë e preferuar.

10 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Edhe për ne anglishtja.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] U mbajt parasysht.

12 Tani do të lëshoj një vendim për këtë çështje në momentin
13 e duhur. Dhe në atë vendim ku përcaktohet data për paraqitjet
14 fillestare dhe çështje të lidhura, vura në dukje se thashë se
15 do të caktoj edhe seancën -- konferencën e statusit për këtë
16 çështje në 17 dhjetor 2024, në orën 2.00, të martën.

17 Ju kam thënë që të paraqisni edhe parashtrime gojore sot
18 nëse do të merrni pjesë personalisht apo nëpërmjet
19 videokonferencës.

20 Z. Avokati i Mbrojtjes.

21 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Faleminderit. Nuk e di nëse është
22 e mundur që ta caktoni një datë tjetër për këtë takim sepse
23 për mua data 17 dhjetor është e pamundur të marr pjesë
24 fizikisht. Nëse jo, nuk e ndryshoni dot, do ta ndjek nëpërmjet
25 konferencës me video.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Prokurori i Specializuar
2 dëshiron të flasë për këtë çështje? Unë e thashë -- e vura re
3 që thatë që jeni të gatshëm të jeni të pranishëm.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, jemi të pranishëm -- jemi të
5 gatshëm ta ndjekim atë konferencë.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E mora parasysht.

7 Do të merrni urdhrin momentin e duhur ku do të përfshihet
8 edhe programi, axhenda. Aty në këtë urdhër do të jap dhe
9 udhëzime për kërkesat lidhur me këtë konferencë për status.

10 Në këtë moment dua t'ju pyes palëve, pra ju palëve, nëse
11 keni ndonjë çështje tjetër që lidhet me seancën e sotme të
12 cilën keni dëshirë ta ngrini tani.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ka një çështje për ne si Prokurori
14 mund ta bëjmë publikisht. Nëse jo pastaj mund të kalojmë në
15 seancë private.

16 Kjo ka të bëjë me kushtet siç paraqiten në paragrafin 4
17 të Shtojcës 5 të vendimit 37, që janë kushtet që duhet të
18 përmbushë z. Kuçi në pritje të gjykimit.

19 Nënparagrafi (c) dhe (d) mund të lexohen për të ndaluar
20 përmbajtjen, sidomos lidhur me bashkautorësinë.

21 Thelbi i kësaj çështje, një nga akuzat për mosbindje të
22 Gjykatës lidhet drejtpërdrejtë me faktin që ai ka marrë detyrë
23 nga z. Thaçi gjatë vizitës jo të privilegjuar në 3 shtator
24 2023, për të kontaktuar dhe për t'i thënë të paktën një
25 personi, dhe me gjasa më shumë se një, po të paktën njërit,

1 një dëshmitari se si të dëshmonte në Çështjen 06. Kjo është
2 baza e akuzës për akuzën e mosbindjes. Ndërsa kemi një mendim
3 tjetër lidhur me numrin e njerëzve të përfshirë në këtë, nga
4 regjistrimi është e qartë se parashikohej që dhe një person
5 tjetër do të ndihmonte në këtë gjë.

6 Kërkesa jonë, e nderuar Gjykatëse, është që z. Kuçi të
7 mos lejohet të flasi me bashkëautorët e tjerë që emërtohen në
8 këtë aktakuzë. Ai e ka akuzën dhe persona të tjera që
9 pretendohet se janë përfshirë në transmetimin apo orvatjen për
10 të transmetuar udhëzimin e z. Thaçi.

11 Nuk do t'jua them emrat tani. Mund t'i paraqes në një
12 parashtrim me shkrim ku të kërkojmë konkretisht që z. Kuçi të
13 ndalohet t'i kontaktojë, sidomos, siç tha dhe vetë, z. Kuçi
14 ishte anëtar i ekipit të Mbrojtjes në një rast tjetër në
15 Çështjen 06 kur është përfshirë në këtë sjellje, në këtë
16 veprim që -- siç konfirmohet në aktakuzë, për të cilën ka një
17 dyshim të mirëbazuar.

18 Bëhet fjalë me mosbindje dhe shpërfilljen e rregullave të
19 këtij Tribunali.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

21 Mbrojtja do të flasi:

22 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk kemi për të thënë gjë.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

24 Pajtohet Prokuroria që të bëjë sot parashtrime me shkrim
25 për këtë çështje?

1 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mund ta bëjmë dhe sot, e nderuar.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Pastaj do të jepet vendim
3 po në momentin e duhur

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] A ka ndonjë çështje
6 tjetër që ndonjëra nga palët dëshiron ta ngrejë në këtë
7 seancë? Nuk ka.

8 Atëherë përfundon këtu seanca për Paraqitjen e Parë të z.
9 Kuçi.

10 Falënderoj palët, Zyrën Administrative për pjesëmarrjen
11 dhe si gjithmonë përkthyesit tanë të çmuar, stenografët,
12 teknikët, personelin e sigurinë për ndihmën e tyre.

13 Seanca merr fund këtu.

14 --- Seanca e Paraqitjes së Parë mbyllet në orën

15 10.26

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25